

Udhëzues për përdoruesit

PREZANTIMI I *LOCAT*-ës (*LOCATA*) – ju ndihmon të gjeni një banesë të re në West London

SI FUNKSIONON *LOCATA*

SI TE BEHEM ANETAR I *LOCAT*-ës?

BARAZI PRANIMI – ÇFARË NDIHME DO TË MARR?

PO NË QOFTË SE DUA TË KALOJ NË STREHIM PËR TË MOSHUARIT?

PO NË QOFTË SE KAM NDONJË PROBLEM SHËNDETËSOR OSE VUAJ NGA NDONJË SËMUNDJE MENDORE?

PO NË QOFTË SE DIKUSH NË FAMILJEN TIME ËSHTË INVALID?

PO NË QOFTË SE MË NDRYSHOJNË RRETHANAT?

SI DO TË MARR PËRGJIGJE PËR KËRKESAT QË KAM BËRË?

SI TË BËJ KËRKESE PËR NJË SHTËPI?

ÇFARË MUNDËSISH TË TJERA EKZISTOJNË PËR STREHIM?

PESË HAPA PËR TË ZGJEDHUR NJË BANESË TË RE

PREZANTIMI I LOCAT-ës - ju ndihmon të gjeni një shtëpi të re në West London

Locat-ën e përdorin Këshillet e Brent-it, Ealing, Hammersmith & Fulham, Harrow-it, Hillingdon-it dhe Hounslow-it si edhe Ealing Family, Paradigm Housing, PCHA, Thames Valley, Acton Housing, Shepherds Bush dhe Stadium Housing Association për të shtuar mundësitë e gjetjes së strehimit.

Locata ju jep më tepër mundësi zgjedhjeje për të banuar aty ku dëshironi. Në të kaluarën, Këshilli juaj vendoste se ku dhe kur do t'ju ofronin një banesë. Tani do të keni mundësinë të zgjidhni.

Qiramarrësit ekzistues të Këshillit dhe Organizatave të Strehimit, të cilët dëshirojnë të transferohen në një shtëpi të re, mund të përdorin *Locat-ën* për të gjetur një shtëpi të re. Këtu përfshihen edhe ata që janë duke kërkuar shtëpi: njerëzit që janë në regjistrin e strehimit ose ata që janë të pastrehë.

Çdo dy javë *Locata* boton një revistë falas, të quajtur *Locata HOME*, ku përfshihen të gjitha shtëpitë bosh të Këshillit dhe të Organizatave të Strehimit. Ju mund të shihni njoftimet dhe të vendosni nëse dëshironi t'ju marrin në konsideratë për ndonjë prej banesave. Interesin për banesat mund ta tregoni duke bërë një kërkesë për to. Në këtë udhëzues për përdoruesit do të gjeni një përmbledhje ku shpjegohet se kush mund të bëjë kërkesa për banesa dhe se si bëhen ato.

Që të merrni një shtëpi të re, duhet të bëni një kërkesë për një banesë tek *Locata HOME*. Këshillat dhe Organizatat e Strehimit që përfshihen në skemën e *Locat-ës*, nuk u japin më banesa njerëzve që nuk kanë bërë kërkesë nëpërmjet saj.

Locata ju jep më tepër mundësi për të banuar aty ku dëshironi. Gjithashtu, ju jep informacion më të plotë mbi llojin e banesave bosh në zonën tuaj.

SI FUNKSIONON LOCATA

Sipas *Locat-ës*, nuk është Këshilli apo Organizata e Strehimit që do t'ju gjejë dhe do t'ju caktojë një banesë. Ju do të kërkonit vetë për banesën tuaj duke përdorur revistën *Locata HOME*.

Shtëpitë bosh do të rekomohen:

- Në revistën tonë "Locata HOME", që është falas dhe që botohet çdo dy javë. Revistën "Locata HOME" mund ta gjeni në pika të ndryshme, si për shembull, në departamentet e strehimit, në zyrat e shërbimeve sociale, në organizatat vullnetare dhe në bibliotekat publike të 6-të zonave të partneritetit. Në qoftë se abonoheni kundrejt një pagese, mund t'juja postojmë direkt. Në faqen tonë të internetit në këtë adresë: www.locata.org

Ju mund të bëni kërkesë për të shumtën 3 banesa për çdo numër të revistës duke mbushur kuponin (që do t'ju dërgohet), duke telefonuar, duke çuar një mesazh me tekst si edhe duke përdorur faqen e internetit të *Locat*-ës.

Anëtarëve të rinj do t'ju jepet i gjithë informacioni, duke përfshirë edhe kuponat.

Revista Locata HOME ka të dhëna:

- Për çdo shtëpi që është e lirë.
- Për qiranë javore.
- Për pronarin e banesës.
- Për kushtet që duhet të përmbushen nga ata që mund të bëjnë kërkesa.
- Se kur do të jetë gati banesa
- Nëse banesa do të jetë objekt kërkesash nga të gjitha zonat
- Herë pas here për informacion lokal, p.sh. për shkollat, transportin, dyqanet, etj

Anëtarët do të jenë ose Qiramarrës (që zakonisht janë me kontratë të siguruar të një autoriteti lokal partner ose qiramarrës me kontratë të siguruar ose të përhershme të një organizate lokale të strehimit) OSE njerëz që kërkojnë shtëpi, ku përfshihen të pastrehët dhe ata që ndodhen në regjistrin e strehimit.

Anëtarët klasifikohen në disa kategori. Pronari juaj ose autoriteti lokal ku do të regjistroheni do t'ju tregojë kategorinë ku bëni pjesë. Përparësia për hyrjen në një kategori varet nga data.

Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të kategorive. Kjo listë nuk i përmban të gjitha kategoritë, prandaj ju duhet të flisni me departamentin e strehimit ku jeni regjistruar, nëse dëshironi më tepër informacion për rastin tuaj konkret.

KATEGORIA A (Urgjente/Prioritet i Lartë)

- Keni një gjendje shëndetësore vdekjeprurëse, që ndikohet seriozisht nga strehimi juaj i tanishëm ose keni ndonjë nevojë tjetër urgjente për të lëvizur.
- Jeni i pastrehë, me nevoja parësore dhe në strehim të përkohshëm dhe pronari kërkon t'i kthehet banesa ose strehimi i përkohshëm nuk ju përshtatet dhe nuk keni mundësi të gjeni strehim tjetër të tillë.
- Punonjësit e strehimit kanë miratuar rekomandimin e bërë nga Shërbimet Sociale që t'ju jepet strehim i përhershëm për qëllime kujdestarie dhe birësimi.
- Jeni qiramarrës dhe ju kërcënojnë me dhunë. Ju lutemi vini re se kjo zbatohet vetëm për qiramarrësit e Këshillit/Organizatave të Strehimit.
- Jeni qiramarrës ish-ushtarak për të cilin Këshilli ka detyrime të kontratuara për ristrehim.
- Jeni qiramarrës që ka nevojë të lëvizë me shtëpi ngaqë banesa do të shkatërohet ose do të rihvillohet.
- Jeni qiramarrës që ka nevojë të lëvizë tek një banesë që është adaptuar.
- Jeni qiramarrës dhe banoni në një banesë që është adaptuar por që nuk keni më nevojë për të e që mund të përdoret nga dikush tjetër.
- Jeni qiramarrës në një banesë me dy ose më shumë dhoma dhe keni dëshirë të lëvizni tek një banesë me një dhomë ose të dorëzoni dy dhoma.
- Keni fituar kontratën me Këshillin dhe ju kanë aprovuar për të lëvizur tek një garsoniere ose tek një banesë me një dhomë ose po dorëzoni dy ose më tepër dhoma.
- Keni zënë një banesë e cila është subjekt i një urdhëri për blerje të detyrueshme dhe/ose Këshilli ka detyrim me ligj t'ju lëvizë.

KATEGORIA B (Nevojë urgjente për të lëvizur)

- Ju keni një nevojë urgjente për të lëvizur për arsye shëndetësore ose sociale, siç është aprovuar nga pronari i banesës suaj.
- Ju keni nevojë urgjente për të lëvizur për shkak të ngacmimeve ose të kërcënimit me dhunë. (Ju lutemi vini re se kjo zbatohet vetëm për qiramarrësit e Këshillit/Organizatave të Strehimit).
- Jeni i pastrehë, Këshilli ka pranuar të marrë në ngarkim ristrehimin tuaj dhe jeni në një "bed & breakfast", në një

fjetore, ose po qëndroni përkohësisht me familjen apo shokët tuaj.

- Ju nuk keni kontratë qiramarrjeje, keni një fëmijë që varet prej jush, nuk keni dhomë dhe ndani me të tjerët gjërat e tjera.
- Ju duhet të lëvizni nga strehimi nën kujdestari ose mbështetës dhe ristrehimi ju është miratuar sipas një plani të veçantë e të përcaktuar.
- Jeni qiramarrës që banoni në një banesë të madhe e keni dëshirë të dorëzoni një dhomë të tepërt, por që akoma keni nevojë për dy ose më shumë dhoma.
- Jeni qiramarrës dhe shtëpia juaj do të shkatërrohet ose sipas normës banesa juaj është e mbipopulluar ose është aprovuar që të lëvizni për arsye të tjera menaxhimi.
- Ju keni fituar kontratën me Këshillin dhe ju kanë aprovuar për të lëvizur tek një banesë më e vogël të përbërë prej dy ose më shumë dhomash.
- Jeni ish-qiramarrës që Këshilli, në kohën që ju prishët kontratën e qiramarrjes së mëparshme, mori përsipër t'ju ristrehojë në të ardhmen.

KATEGORIA C (Nevoja të identifikuara strehimi)

- Ju duhet të lëvizni për nevoja shëndetësore ose për shkak të kushteve të pakënaqshme të strehimit si p.sh. mbipopullimi ose mungesa e kushteve sanitare.
- Nevoja që keni për të lëvizur është e identifikuar në planin e kujdesit të Shërbimeve Sociale ose është e miratuar nga Shërbimet Sociale si një nga mënyrat për të lehtësuar vështirësitë sociale.
- Ju jeni një person i moshuar dhe do të lëvizni në banesë për të moshuarit.
- Jeni i pastrehë, por nuk kualifikoheni në Kategorinë A ose B.

KATEGORIA D

- Të gjithë Qiraxhinjtë e tjerë të transferuar dhe ata që nuk futen në kategoritë e mësipërme A, B ose C.

SI TË BËHEM ANËTAR I LOCAT-ës?

Ju bëheni automatikisht anëtar i *Locat*-ës nëse jeni qiramarrës i një pronari që është partner i saj dhe jeni regjistruar për një transferim, ose nëse jeni në kërkim të një shtëpie, ku përfshihen të pastrehët dhe të tjerët në Regjistrin e Strehimit të një prej këshillave partnerë.

Të tjerët duhet të regjistrohen nëpërmjet pronarit të tyre ose Departamentit të Strehimit të këshillit lokal.

TË DREJTA TË BARABARTA PËR PËRDORIM – ÇFARË NDIHME DO TË MARR?

Personeli i kualifikuar i strehimit, punonjësit e socialit dhe agjencitë vullnetare janë gati për të këshilluar aplikantët e pambrojtur dhe ata që kanë vështirësi gjuhe ose leximi në mënyrë që t'ju ndihmojnë të përdorni Locata HOME për të gjetur një banesë.

Çdo njeri duhet të përdorë Locata HOME për t'u ristrehuar. Në qoftë se nuk bëni kërkesë për shtëpitë që janë të lira, nuk do t'ju jepet asnjë ofertë.

PO NËSE DËSHIROJ TË LËVIZ NË STREHIM PËR TË MOSHUARIT?

Strehimi për të moshuarit është i ndërtuar posaçërisht dhe i konceptuar për njerëz të moshuar dhe të pavarur që janë të aftë të kujdesen për veten në shumicën e rasteve. Shumica e koplekseve për të moshuarit kanë një kujdestar ose manaxher që është i gatshëm për të ndihmuar ose për të këshilluar. Që të bëni kërkesë për strehim për të moshuarit, duhet të jeni cilësuar si person që ju takon një strehim i tillë. Për të ditur se çfarë ju takon ose për të marrë informacion shtesë mbi ofertat ekzistuese, ju lutemi kontaktoni pronarin e banesës suaj ose departamentin e strehimit.

PO NË QOFTË SE KAM NDONJË PROBLEM SHËNDETËSOR OSE VUAJ NGA NDONJË SËMUNDJE MENDORE?

Në qoftë se ju ose një pjesëtar i familjes suaj ka ndonjë problem shëndetësor ose ka nevoja të tjera të veçanta, duhet të mbushni një formular mjekësor vetëvlerësues. Në të ju kërkohen të dhëna mbi gjendjen shëndetësore si edhe shpejgime mbi ndikimin negativ të strehimit tuaj të tanishëm dhe përse duhet të lëvizni me shtëpi. Këshilltari ynë mjekësor do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe pastaj do të vendosë nëse ristrehimi juaj është i nevojshëm dhe urgjent.

PO NË QOFTË SE DIKUSH NË FAMILJEN TIME ËSHTË INVALID?

Kur të plotësoni formularin mjekësor vetëvlerësues, do t'ju pyesin nëse ju ose një pjesëtar tjetër i familjes suaj ka vështirësi në ecje

ose në ngjitjen e shkallëve, që mund të ndikojë mbi llojin e banesës që mund t'ju ofrohet. Për shembull, në qoftë se një anëtar i familjes suaj përdor një karrocë invalidi, mund t'ju dërgojmë një terapist për t'ju vizituar dhe për të vlerësuar nevojat e familjes suaj për strehim.

Në qoftë se ju konsiderojnë si person me nevoja të veçanta për adaptime, do të bëni pjesë në njërin nga këto grupe:

- Grupi 1 i invalidëve – përdorues i karrocës së invalidëve brenda dhe jashtë shtëpisë.
- Grupi 2 i invalidëve – njerëz që nuk ecin dot ose që nuk mund të përdorin shkallët por mund të përdorin karrocën e invalidëve në të shumtën e kohës.
- Grupi 3 i invalidëve – ata që janë në gjendje të bëjnë vetëm 1 ose 2 hapa ose të ngjisin shkallët.

Banesat e përshtatshme për njerëzit që bëjnë pjesë në Grupin tuaj të Invaliditetit do të specifikohen në njoftime dhe zakonisht për këto banesa do t'u jepet prioritet njerëzve në Grupin tuaj të Invaliditetit.

PO NË QOFTË SE MË NDRYSHOJNË RRETHANAT?

Ju duhet të njoftoni Këshillin/Organizatën e Strehimit tuaj për çdo ndryshim në familjen tuaj në lidhje me gjendjen shëndetësore ose me situatën e strehimit. Kjo ka shumë rëndësi pasi mund të ndikojë në ndërrimin e Grupit tuaj ose në zgjedhjen tuaj për shtëpi të caktuara.

SI MUND TË BËJ KËRKESË PËR NJË SHTËPI?

Ju mund të aplikoni për tre banesa maksimumi të reklamuar në çdo botim të "Locata HOME" duke mbushur thjesht një kupon, me telefon ose me mesazh teksti. Gjithashtu, mund të bëni kërkesat tuaja edhe nëpërmjet internetit, duke përdorur faqen e shënuar "Bëni aplikimin tuaj" (Make your bid). *Locata* bën përputhjen e kërkesave me banesat dhe kontrollon nëse çdo aplikanti i takon banesa që ka kërkuar. Pastaj *Locata* vendos të gjitha banesat e zgjedhura sipas prioritetit dhe i dërgon pronarit një listë të tyre.

Bërja e kërkesave tuaja nëpërmjet Internetit

1	Hapni internetin dhe shkoni te:	www.locata.org
2	Klikoni tek lidhja 'login'	Kjo do t'ju çojë tek ekrani "login"
3	Zgjidhni tre shkronjat që përfaqësojnë emrin e zonës suaj dhe pastaj fusni numrin që është pjesë përbërëse e Numrit LIN:	P.sh. Nëse jeni Anëtar i Ealing me këtë LIN: EAL12345, ju duhet të zgjidhni "EAL" nga lista e plotë dhe pastaj shtypni "12345" në hapësirën pranë saj
4	Në hapësirën e caktuar shënoni datëlindjen tuaj	P.sh. 31 Jan 1960
5	Kjo do t'ju çojë tek faqja e anëtarëve. Këtu mund të kontrolloni për banesa, të ngarkoni faqen falas dhe të bëni kërkesën tuaj. Që të bëni kërkesën tuaj, klikoni tek lidhja e shënuar 'Bid for properties' (fusni kërkesën për banesa)	Kjo do t'ju çojë tek faqja e bërjes së kërkesave.
6	Për të bërë kërkesën tuaj, shtypni 3 shifrat e numrit të referencës së banesës në hapësirën që ndodhet pranë 'Bid 1', 'Bid 2' dhe 'Bid 3'.	P.sh. Në qoftë se po fusni kërkesën për 3 banesa me numra reference 428, 387 dhe 621, shtypni pranë fjalëve 'Bid 1' numrin "428", pranë 'Bid 2' shtypni "387" dhe pranë 'Bid 3' shtypni "621"
7	Klikoni te butoni 'Submit Bids'.	
Kaq ishte dhe kërkesat tuaja janë bërë.		

Bërja e kërkesave tuaja me mesazh të shkruar nëpërmjet celularit

	<u>Çfarë duhet të bëni</u>	<u>Shembull</u>
1	Që të filloni të bëni kërkesat tuaja:	Filloni një mesazh tekst të ri
2	Duke shtypur butonat shënoni numrin tuaj LIN:	BRE12345
3	Dhe pastaj shtypni këtë shenjë #:	BRE12345#
4	Tani shënoni numrin e referencës së reklamës për kërkesën tuaj të parë dhe menjëherë pas saj shtypni shenjën #:	BRE12345#456#
Nëse keni mbaruar kërkesën, dërgojeni. Ndryshe, ndiqni instruksionet e mëposhtme.		
5	Tani ju duhet të shtypni numrin e referencës së kërkesës 2 dhe menjëherë pas saj shtypni këtë shenjë #:	BRE12345#456#491#
Nëse keni mbaruar kërkesën, dërgojeni. Ndryshe, ndiqni instruksionet e mëposhtme.		
6	Tani ju duhet të shtypni numrin e referencës së kërkesës 3 dhe menjëherë pas saj shtypni këtë shenjë #:	BRE12345#456#491#444#
7	Kur të keni bërë të gjitha kërkesat tuaja, dërgoni mesazhin-tekst:	“Send”
8	Numri ku do të dërgoni kërkesat tuaja është:	07800 140767
<ul style="list-style-type: none">• Çmimi i mesazheve tekst SMS i shumicës së kompanive të telefonave celularë është rreth 10p për tekst.• Për të shtuar numrat në mesazhin tuaj vazhdoni të shtypni butonat deri sa të gjeni shifrën që ju nevojitet dhe pastaj bëni zgjidhjen e saj.• Për të gjetur shenjën # në shumicën e telefonave celularë, shtypni më parë butonin me shenjën e yllit dhe pastaj zgjidhni shenjën #.• Ju mund të dërgoni kërkesat tuaja me shkronja të vogla ose të mëdha të shtypit.• Para se të dërgoni kërkesat tuaja kontrolloni numrin LIN dhe kërkesat tuaja.		

Bërja e kërkesave tuaja nëpërmjet telefonit

	<u>Cfarë duhet të bëni</u>	<u>Shembull</u>
1	To begin making your bids dial: (Që të filloni bërjen e kërkesave tuaja telefononi këtë numër):	0906 294 2012
2	You will hear: (Do të dëgjoni këtë mesazh):	“Welcome to the Locata Property Line, Please select the Borough or RSL you are registered with from the following list.” (Mirë se erdhët tek Linja telefonike e banesave të Locat-ës. Ju lutem zgjidhni lagjen [borough] ose RSL-në në të cilën jeni regjistruar, nga lista e mëposhtme.)
	Press 1 (Shtypni 1) Press 2 (Shtypni 2) Press 3 (Shtypni 3) Press 4 (Shtypni 4) Press 5 (Shtypni 5) Press 6 (Shtypni 6) Press 7 (Shtypni 7)	Për Brent Për Ealing Për Harrow Për Hillingdon Për Hounslow Për Ealing Family Housing Association Për PCHA
3	You will then hear: (Pastaj do të dëgjoni këtë mesazh):	“Thank you. Please enter the number section of your LIN number.” (Faleminderit. Ju lutem fusni pjesën numerike të numrit tuaj LIN)
4	You should now enter the numerical part of your LIN number only. Once you have entered the correct number you will hear: (Tani duhet të shtypni vetëm pjesën numerike të numrit tuaj LIN. Nëse keni shtypur numrin e duhur do të dëgjoni):	“Thank you. Please enter the day number of your birth date” e.g. (Faleminderit. Tani fusni numrin e datës së lindjes tuaj. Për shembull:) Për 16/04/60 numri është 16 Për 08/01/58 numri është 08 (duhet të vini një zero përpara një numri me një shifër) Për 23/06/31 numri është 23
5	You should now enter the day number of your date of birth. Once you have entered the correct number you will hear: (Tani duhet të shtypni vetëm datën e ditës së lindjes suaj. Nëse keni shtypur numrin e duhur, do të dëgjoni këtë mesazh):	“Thank you. Please enter your first property reference bid number.” (Faleminderit. Ju lutem fusni numrin e referencës së banesës së parë për të cilën doni të bëni kërkesë)
6	Once you have entered the property reference number correctly you will hear: (Nëse keni dhënë të saktë numrin e referencës	“Thank you. If you would like to add an additional bid press one or press two to complete your bids.” (Faleminderit. Në qoftë se dëshironi të

	së banesës, do të dëgjoni këtë mesazh):	shtoni një kërkesë tjetër shtypni 1, ose shtypni 2 për të përfunduar bërjen e kërkesës suaj.)
7	If you have pressed one you will hear: (Nëse keni shtypur një, do të dëgjoni këtë mesazh):	“Please enter your second property bid number or press the star key to complete your bidding.” (Ju lutem fusni numrin e banesës së dytë ose shtypni butonin me yll për të përfunduar bërjen e kërkesës.)
8	Once you have entered the second property reference number correctly you will hear: (Pasi të keni dhënë numrin e referencës së banesës së dytë, do të dëgjoni këtë mesazh):	If you would like to add an additional bid, please press one now or press two to complete your bidding.” (Në qoftë se dëshironi të shtoni një kërkesë tjetër shtypni 1, ose shtypni 2 për të përfunduar bërjen e kërkesës suaj.)
9	When you have finished bidding you will hear: (Pasi të keni mbaruar të gjitha kërkesat, do të dëgjoni këtë mesazh):	“Thank you for bidding on the Locata Property line.” (Faleminderit për kërkesat që bëtë në Linjën telefonike Locata.)
Në qoftë se keni bërë gabime, do të dëgjoni instruksionet që vijojnë:		
10	If you have made an error with your number you will hear: (Në qoftë se keni bërë një gabim në lidhje me numrin tuaj, do të dëgjoni këtë mesazh):	“I am sorry, the LIN number you have entered is not recognised. Please try again.” (Më vjen keq, numri LIN që keni dhënë nuk njihet. Ju lutem provojeni përsëri.)
Në këtë rast jepni përsëri numrin tuaj duke shtypur me kujdes numrin e saktë		
11	If you make further errors you will hear: (Nëse bëni gabime të tjera, do të dëgjoni këtë mesazh):	“I am sorry, the LIN number you have entered is not found. Please check with your registering partner and call again.” (Më vjen keq, numri LIN që keni dhënë nuk gjendet. Ju lutem pyni partnerit tuaj rregjistrues dhe telefononi përsëri.)

Bërja e kërkesave me kupon

<p>Kuponi juaj ka të shtypur emrin dhe numrin tuaj LIN (Numri i Identifikimit të Locata) – ju lutemi kontrolloni nëse këto të dhëna janë të sakta.</p>	<p>Ju duhet të shënoni një X në kolonën e dytë përballë numrit që përfaqëson shifrën e dytë të numrit të referencës.</p>
<p>Ju mund të bëni kërkesa vetëm për tre banesa maksimumi për çdo botim të faqes me njoftime.</p>	<p>Ju duhet të shënoni një X në kolonën e tretë e cila duhet të jetë e njëjtë me shifrën e tretë të numrit të referencës.</p>
<p>Çdo banesë ka një numër reference me 3 shifra, e cila jepet në reklamën e banesave në faqen e veçuar të revistës “Locata HOME”.</p>	<p>Shënoni datën në fillim të faqes së veçuar të Locata HOME, tek e cila po bëni kërkesat tuaja për banesa.</p>
<p>Për shembull, në qoftë se dëshironi të bëni kërkesë për banesat të cilat kanë numra reference me 3 shifra: 456; 491 dhe 444, ju duhet të shënoni kuponin sipas shembullit të dhënë. Ju duhet të vini një X në kolonën e parë në përputhje me shifrën e parë përkatëse të numrit të referencës.</p>	<p>Ju lutemi dërgoni me postë kuponin tuaj te Locata. Adresa është shënuar në kupon, por ju duhet të ngjisni një pullë.</p>

Bids for properties in this edition have to be received by the closing date shown on the front cover, please fill your coupon in with black or blue ink only.

Bid 1			Bid 2			Bid 3		
1	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	1	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	1	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	2	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	2	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	3	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	3	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	4	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	4	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
5	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	5	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	5	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	6	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	6	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	7	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	7	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	8	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	8	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	9	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	9	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	0	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	0	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Freeshet Date
3 0 0 4 0 4
D D M M Y Y

Porositja e kuponave nëpërmjet Telefonit

1	Për të porositur kuponat tuaj telefononi:	0906 294 2013
2	Do të dëgjoni këtë mesazh: Shtypni 1 Shtypni 2 Shtypni 3 Shtypni 4 Shtypni 5 Shtypni 6 Shtypni 7	<p>“Welcome to the Locata Coupon line. Please select the Borough or RSL you are registered with from the following list.”</p> <p>(Mirëseerdhët në Linjën telefonike të kuponave të LOCAT-ës. Ju lutem zgjidhni Borough ose RSL-në në të cilën jeni rregjistruar nga lista e mëposhtme.)</p> <p>Për Brent Për Ealing Për Harrow Për Hillingdon Për Hounslow Për Ealing Family Housing Association Për PCHA</p>
3	Pastaj do të dëgjoni këtë mesazh :	<p>“Thank you. Please enter the number section of your LIN number.”</p> <p>(Faleminderit. Ju lutem shtypni pjesën numerike të numrit tuaj LIN.)</p>
4	Tani duhet të fusni vetëm pjesën numerike të numrit tuaj LIN. Pasi të keni futur numrin e saktë do të dëgjoni këtë:	<p>“Thank you. Please enter the day number of your birth date” e.g. (Faleminderit. Ju lutem futni numrin e datës së datëlindjes suaj. Për shembull)</p> <p>Për 16/04/60 numri është 16 Për 08/01/58 numri është 08 (duhet të vini një zero para një numri me një shifër) Për 23/06/31 numri është 23</p>

SI DO TË MË KTHEJNË PËRGJIGJE NË LIDHJE ME KËRKESAT E MIA?

Të gjitha banesat ndodhen në një listë në seksionin e përgjigjeve të revistës Locata HOME. Ne do t’ju tregojmë numrin e të interesuarve për çdo banesë si edhe grupin dhe datën e regjistrimit të kërkuesit që do të jetë i suksesshëm. Kjo do t’ju ndihmojë që të llogarisni shkallën e prioritetit tuaj në krahasim me atë të atyre që kanë dalë të suksesshëm. Pastaj, ju mund të përshtasni kërkesat tuaja ose për zonën, ose për llojin e banesës në qoftë se dëshironi të lëvizni shpejt.

PESË HAPA PËR TË ZGJEDHUR NJË BANESË TË RE

HAPI 1 ANTARËSIA

Ju mund të jeni një qiramarrës ekzistues, ndoshta i pastrehë, ndoshta qiramarrës me pronar të sektorit privat, pronar/banor ose banoni me familjen ose me shokë.

HAPI 2 REGJISTRIMI

Këshilli juaj lokal dhe organizata e strehimit do të vërtetojnë me shkrim regjistrimin dhe kategorinë në të cilën bëni pjesë.

HAPI 3 ZGJEDHJA

Revistën tonë falas "Locata HOME" mund t'a merrni në disa pika. Ju mund të bëni kërkesë nëpërmjet kuponit, telefonit; tekstit ose shkoni tek faqja internetit për shtëpinë që keni zgjedhur.

HAPI 4 KËRKESA

Nëse kërkesa juaj është në krye të listës, Këshilli Lokal ose Organizata e Strehimit do t'ju kontaktojë që ju të vizitoni banesën.

HAPI 5 PËRGJIGJE

Locata HOME do të botojë të dhëna për numrin e njerëzve që kanë bërë kërkesë për banesë në numrat e mëparshëm.

ÇFARË MUNDËSISH TË TJERA EKZISTOJNË PËR STREHIM?

Në Londrën perëndimore ka shumë pak shtëpi, prandaj ky plan nuk do të zgjidhë problemet e strehimit të çdo personi. Disa prej anëtarëve do të presin për një kohë të gjatë për t'u ristrehuar dhe shumica e anëtarëve të kategorive C dhe D do të kenë pak shanse ristrehimi në zonën lokale. Në mënyrë që t'ju japim më tepër mundësi ne do t'ju njoftojmë për shtëpi jashtë Londrës, si p.sh. në Midland, ku kërkesat janë më të pakta si edhe për shtëpi të përbashkëta në Londrën perëndimore. Në revistën Locata HOME do të gjeni edhe shtëpi që jepen me qira në sektorin privat.

LISTA E PLOTË E PRONARËVE**Numra telefonash**

London Borough of Brent
 Mahatma Ghandi House
 34 Wembley Hill Road
 Wembley, Middlesex
 HA9 8AD

020 8937 2000

London Borough of Ealing
 Housing Resource Centre
 Town Hall Annexe
 New Broadway
 London
 W5 2BY

020 8825 7274

London Borough of Harrow
 Youngmans 2 Building
 PO Box 65
 Civic Centre
 Station Road
 Harrow, Middlesex
 HA1 2XG
 Email: locatahelp@harrow.gov.uk

Surnames
 A to Cg
 Ch to G
 H to Lg
 Lh to O
 P to Sg
 Sh to Z

020 8424 1116
 020 8863 5611
 020 8424 1706
 020 8424 1115
 020 8863 5611
 020 8863 5611

ext.3870

 ext.3738
 ext.3663

London Borough of Hillingdon
 Housing Services
 Civic Centre
 High Street
 Uxbridge, Middlesex
 UB8 1UW
 Email: nmailbox@hillingdon.gov.uk

01895 250 328
 01895 277 779
 01895 250 147
 01895 250 389

London Borough of Hounslow
 The Civic Centre
 Lampton Road
 Hounslow
 TW3 4DN

020 8583 3815
 020 8583 4405

Ealing Family Housing Association
 St James House
 105-113 Broadway
 West Ealing
 London
 W13 9BE
 Email: csc.queries@chq.org.uk

020 8621 9898

Paradigm Housing Group
 1 White Hill
 Chesham
 Bucks
 HP5 1AB

0845 845 5517

PCHA Housing Association
 324 Harrow Road
 London
 W9 2HP

020 8537 4537